

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

MARRËVESHJE PËR SUBVENCIONIM

ndërmjet

Komunës së Gjilanit si autoritet publik

dhe

Yllkë Jashari nga Gjilani, përfituese

Gjilan, 2022

Neni 1
Qëllimi i marrëveshjes

1. Qëllimi i kësaj marrëveshje është përkrahja financiare e Yllkë Jasharit nga Gjilani, për arritjen e rezultateve në shumë gara vendore dhe ndërkombëtare për Matematikë.
2. Marrëveshja është lidhur sipas procedurës së përcaktuar me Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 2/2018,01 nr. 016-28468 dt. 22. 03.2018 (neni 13 dhe neni 14 paragrafi 1.8) dhe Rregullores për fondin e Ekselencës 01. nr. 17008 të datës 27.02.2017 (neni 4).

Neni 2
Vlera e Subvencionimit

Vlera e subvencionimit sipas nenit 1 paragrafi 1 të kësaj marrëveshje është **500 €** (pesëqind euro) dhe pagesa bëhet nga Kodi Buxhetor-Subvencione-Zyra e Kryetarit.

Neni 3
Obligimet e palëve

1. **Obligimet e përfitueses së subvencionit janë:**
 - 1.1. Mjetet e marra, përfituesja do t'i shfrytëzoj vetëm për qëllimet siç u cekë më lartë.
 - 1.2. Përfituesja duhet të raportoj tek Komuna e Gjilanit.

Neni 4

1. **Obligimet e Komunës së Gjilanit janë:**
 - 1.1. Obligohet që shumën nga paragrafi 1 i nenit 2 të kësaj marrëveshje t'ia transferoj në xhirollogarinë bankare të përfitueses, sipas kushteve të parapara me këtë marrëveshje;
 - 1.2. Bartja e mjeteve financiare do të bëhet në pajtim me rregullat financiare mbi pagesat.
2. Komuna e Gjilanit mbanë të drejtën e monitorimit/inspektimit dhe auditimit të realizimit të qëllimeve të subvencionimit, po që se paraqitet nevoja.

Neni 5

Kjo marrëveshje është e vlefshme pas datës së nënshkrimit nga palët.

Neni 6
Kthimi i mjeteve

Në rast të rrethanave të ndryshme të cilat rezultojnë deri te mos realizimi i subvencioneve, përfituesja është e obliguar t'i kthejë mjetet e pa shpenzuara tek Komuna e Gjilanit.

Neni 7
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje eventuale lidhur me këtë marrëveshje, palët do ta zgjidhin vet, me synimin e përmirësimit dhe të realizimit të qëllimit të kësaj marrëveshje.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga ana e dy palëve.


Neni 9

Marrëveshja është përpiluar në 2 kopje të njëjta ku secila palë do të marrë nga një kopje.



Yllkë Jashari , përfituese

prer Yllkën



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 , nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Gjiçanit 01. nr. 16-126211 të datës 06.11.2014, me ndryshimet dhe plotësimet në Statut 01. nr. 016-28448 të datës 22.03.2018, Kryetari i Komunës së Gjiçanit merë këtë:

V E N D I M

1. Me këtë vendim lejohet pagesa e mjeteve financiare në shumën prej 500 €(pesëqind euro) për Yllkë Jasharin nga Gjiçani, për arritjen e rezultateve në gara vendore dhe ndërkombëtare për matematikë.
2. Pagesa e mjeteve financiare bëhet nga Kodi Buxhetor-Subvencione-Zyra e Kryetarit të Komunës.
3. Mjetet derdhen në emër të Yllkë Jasharit në xhirollogarinë [REDACTED]
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Pjesë e këtij vendimi është Marrëveshja për Subvencionim.
6. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet

- Palës
- DBF-së dhe
- Arkivit.

